

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“34 SECURITY”**

Sot më datë 10.01.2025, unë Luis DOSHI, i biri i Tomë-s, lindur më datë 22.07.2004, në Australi dhe banues në Rruga “Nikolla Zoraqi”, Nd.11, H.1, Tiranë, shtetas shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me Numër Personal K40722061L,

bazuar në legjACIONIN NË FUQI, veçanërisht bazuar në nenet 68 e vijues të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, në Ligji nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, në dispozitat e Kodit Civil, në cilësinë e ortakut themelues si dhe në vullnetin tim të lirë të shprehur dhe në nënshkrimin e akteve të themelimit të shoqërisë kam hartuar aktin e themelimit dhe statutin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar:

**KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, më datë 10.01.2025 themelohet nga ortaku themelues shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin “34 Security” (*në vijim Shoqëria*), e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi sh.p.k.

(2) Themeluesi i Shoqërisë është:

Luis DOSHI, i biri i Tomë-s, lindur më datë 22.07.2004, në Australi dhe banues në Rruga “Nikolla Zoraqi”, Nd.11, H.1, Tiranë, shtetas shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me Numër Personal K40722061L.

(3) Shoqëria mund të hap zyra përfaqësimi, degë dhe/ose filiale, të marrë pjesë në shqoqëri të tjera, të kryejë aktivitete në vende të tjera brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, apo Ortakut të vetëm të Shoqërisë, që do të miratohen herë pas here.



Neni 2 Objekti i Shoqërisë

Objekti i veprimitarisë së shoqërisë është:

1. Ruajtjen e objekteve dhe institucioneve publike dhe private, sigurimin fizik, mbrojtjen e jetes dhe shendetit te shtetesave vendas dhe te huaj, instalim dhe perdomim i sinjalistikes te radioalarmit dhe paisjeve te paisjeve te tjera te vezhgimit.
2. Prodhim mirembajtje dhe tregetim i paisjeve dhe lendeve te shuarjes se zjarrit dhe shpetimit. Projektim dhe instalim i kontrollit te aksesit dhe te sigurise se larte, integrimi i sistemeve.
3. Projektim, furnizim, instalim dhe mirembajtje e sistemeve per prodhimin e energjise alternative (fotovoltaik, wind etj).
4. Furnizim dhe instalim i kasafortave cavoux, sigurine e kutive te depozitave , terminale POS, ATM dha pajisjeve bankare ne per gjithesi Konsulencë dhe analize te sigurise.
5. Projektim, furnizim, instalim dhe mirembajtja e sistemeve te inteligences. Projektim, zbatim dhe mirembajtje ter sistemeve dhe monitorimi i sistemeve te shuarjes se zjarrit.
6. Projektim dhe instalim i pajisjeve dhe impjanteve elektrike e civile.
7. Furnizim, instalim dhe mirembajtje i pajisjeve te telekomunikacionit dhe radio nderlidhjes/import eksport me shumice dhe pakice i materialeve te teknologjise elektrike dhe elektronike, pajisje per navigacion.
8. Në përputhje me legjislacionin shqipëtar, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjeter që mund të konsiderohet i nevojshëm, i dobishëm apo ndihmës në përbushjen e qëllimeve të mësipërme.

Neni 3 Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e themelimit të Shoqërisë.

Neni 4 Selia

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga "Qemal Stafa", Zona Kadastrale 8140, Pl.1, N.1, 1005 Tiranë, Albania.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:

- a) e-mail : 34shpsf@gmail.com;

KREU II KAPITALI

Neni 5 Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestар i shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) Lekë, i përbërë nga 1(një) kuotë.

(2) Kapitali i shoqërisë zotërohet si më poshtë vijon:

Ortaku themelues Luis DOSHI: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 000 (njëqind mijë) Lekë që përben 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

(1) Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

(2) Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

(3) Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

(4) Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

(1) Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

(2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

(3) Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme me rrugë trashëgimie, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III
ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimarres

- (1)** Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarres i shoqerise.
- (2)** Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
- (3)** Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në proçedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gi) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - ij) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- (4)** Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- (5)** Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- (6)** Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9
Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

- (1)** Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

(2) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10
Kuorumi

(1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 pér qind të kuotave.

(2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë pér çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

(3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet pér shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

Neni 11
Marrja e vendimeve

(1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, pér ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

(2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, pér çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

(3) Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB-së per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

Neni 12
Përjashtimi nga e drejta e votës

(1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim pér:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

(2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një person fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

(2) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë, duke patur të drejta të pakufizuara administrimi:

Klodjan Mema, i biri i Nazmi-ut, lindur më datë 21.05.2081, në Tiranë dhe banues në Rrugë “Qemal Stafa” 4/111, Hyrja 1, Ap. 32, Tiranë, shtetas shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me dokumentin tip letërnjoftim ID Nr. 035775903 dhe Numër Personal I10521143D.

Neni 14 Kompetencat e Administratorëve

(1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për “Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

(2) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Neni 15 Pergjegjesite e Administratorit

(1) Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

(2) Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

(3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

(2) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

(3) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua.

(4) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.
- (5)** Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit
- (6)** Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV
VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 16
Viti Financiar

- (1) Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
- (2) Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

Neni 17
Ekspertet

- (1) Eksperti ka per detyre qe tё kontrolloje tё gjithe dokumentacionin kontabel tё veprimtarise ekonomiko tregtare tё shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike tё ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje tё tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- (2) Ne perfundim tё kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit tё bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike tё ushtruara, tё cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e tё drejtes vendimore qe ka.

Kreu V
PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18
Prishja dhe likuidimi

- (1) Shperndarja ose prishja e shoqerise mund tё behet ne cdo kohe :
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
 - b) me vendim tё Asamblese se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave tё falimentimit;
 - ç) nёse nuk ka kryer veprimtari tregtare pёr dy vjet dhe nuk ёshtё njoftuar pezullimi i veprimtarisё;
 - d) me vendim tё gjykatёs;
- (2) Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne tё cilin parashikojne menyren e likuidimit tё shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument tё nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".
- (3) Prishja e shoqёrive tregtare ka si pasojё hapjen e procedurave tё likuidimit nё gjendjen e aftesisё paguese, me pёrashtim tё rasteve kur ёshtё nisur njё procedurё falimentimi.
- (4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emёruar nga Ortaket.
- (5) Nёse Ortaket nuk merrin njё vendim pёr emёrimin e likuiduesve, brenda 30 ditёve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatёs, pёr tё caktuar njё likuidues.

Neni 19
Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore mbi shoqëritë tregtare.

Neni 20
Baza Ligjore

- (1) Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- (2) Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21
Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

O R T A K U I V E T E M
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
34 SECURITY SH.P.K

Luis DOSHI

Luis Doshi 